

HUTBEJA SI BARTËSE E MESAZHIT HYJNOR NË BOTËN MODERNE

Komunikimi është bërthama elementare e shpalljes hyjnore e po ashtu edhe e dërgesës pejgamberike. Teksti i shpalljes dhe porositë profetike janë të thëna, me qëllim që t'i komunikohen në trajta të ndryshme gjinisë njerëzore. Pikërisht për këtë, metodologjia e komunikimit të diskursit hyjnor dhe atij profetik ka ngjallur interesin e veçantë të filozofisë së gjuhës kuranore dhe të haditheve të Pejgamberit (a.s.). Gjithashtu edhe një nga problemet dhe defektet kryesore të gjuhës fetare në botën bashkëkohore, është mangësi (defekt) e komunikimit joadekuat dhe i trajtës jofetare të përdorimit të gjuhës së shpalljes dhe bisedës profetike.

Hutbeja është media më e përhapur dhe më e rëndësishme islame. Vlera e hutbes pasqyrohet në faktin se ka një rëndësi të veçantë në thirrjen islame. Ajo është një mjet i saj tradicional, mirëpo njëkohësisht edhe bashkëkohor. Për shkak të lidhjes me namazin e xhumasë, ku bëhet takimi javor i myslimanëve, ajo vazhdon t'i mbijetojë çdo kohe dhe çfarëdo zhvillimi. Madje, për shkak të karakteristikave që disponon, vazhdon të mbetet si mjeti më efikas në bartjen e mesazhit islam te besimtarët. E kjo, në njëfarë forme, na detyron që hutbes, në përgjithësi, t'i kushtojmë vëmendje dhe rëndësi.

Duke pasur parasysh se institucioni i hutbes është paraqitur menjëherë pas paraqitjes së Islamit dhe vetë i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), ka qenë hatib-ligjërues, vlera historike e këtij lloji të komunikimit i tejkalon të gjitha llojet e tjera specifike të retorikës islame (vazet, derset etj.), për shkak se, krahas bisedës dhe komunikimit të realitetit fetar, ngërthen edhe përmasën e adhurimit dhe përkushtimit ndaj Zotit.

Vlera e hutbes në jetën bashkëkohore dhe ndikimi i saj në popullatën fetare, varet nga dy aspekte thelbësore: përmbajtja e hutbes dhe zgjedhja e temave ose, thënë ndryshe, përmbajtja dhe forma se si do të shtjellohet tema, që të jetë e kapshme për dëgjuesit-auditorin.

Sa i përket përmbajtjes së hutbes, hatibët bashkëkohorë duhet t'i kenë në konsideratë faktet e mëposhtme:

- Xhematet (njerëzit që marrin pjesë në dëgjimin e hutbes), janë me përbërje heterogjene, pra, kanë në to njerëz të strukturave të ndryshme, duke filluar prej moshës, edukimit dhe strukturave socio-ekonomike. Në xhematet nëpër qytete dhe në zonat urbane, në dëgjimin e hutbeve kemi të pranishëm një numër të konsiderueshëm të intelektualëve, studentëve dhe nxënësve.
- Dëgjuesit e hutbes, në të shumtën e rasteve, kanë njohuri të ndryshme rreth Islamit, që i kanë përfituar nëpërmjet mediave, librave, revistave, programeve në televizion dhe radio.
- Përmbajtja e hutbeve dhe zgjedhja e temave duhet të përcaktohet nga aktualiteti dhe dukuritë e caktuara që paraqiten në atë vend, ose problemet që e shqetësojnë shoqërinë.
- Përmbajtja e hutbes duhet të jetë e mbushur me mesazhe fetare, sepse mbahet në xhami dhe se është një ibadet i përcaktuar nga Zoti.
- Përmbajtja e hutbeve nuk duhet të nënvlerësojë aftësitë, profesionet dhe pritjet e besimtarëve, të cilët vijnë në xhami ditëve të premtë prej motiveve fetare dhe atyre edukative që zotërojnë.

Sa i përket mënyrës dhe formës së komunikimit gjatë hutbes, hatibi duhet të jetë i informuar, i trajnuar siç duhet, që të formojë, të ruajë dhe të zhvillojë komunikimin intensiv me xhematin e tij. Komunikologjia ka zhvilluar rregulla dhe ligje të komunikimit të suksesshëm, të cilat duhet të përfshihen në hutbe nga hatibi gjatë predikimit të tij. Një hutbe me përmbajtje të mirë mund të shkatërrohet nga mosrespektimi ose injorimi i rregullave të komunikimit.

Si shembull, çdo hatib i rëndomtë duhet ta dijë se ka tri lloje të ligjëruesve – oratorëve:

- a. Ligjëruesit që i lexojnë tekstet e përgatitura (për ta thonë se janë të bezdisshëm).
- b. Ligjëruesit që flasin përmendësh atë që e kanë shkruar (për ta thonë se i gënjejnë dëgjuesit dhe se janë artistë).
- c. Ligjërues që shfaqen pa ndonjë përgatitje paraprake, të cilët improvizojnë (për ta thonë se janë të pasuksesshëm, pa marrë parasysh se në ligjëratat e tyre kanë rregullsi dhe saktësi).

Kjo ndarje e folësve nuk mund të zbatohet plotësisht dhe në mënyrë korrekte te hatibët, sepse asnjë hatib serioz nuk mund dhe nuk duhet t'i

lejojë vetes që të improvizojë dhe të bëjë gabime në interpretimin e Islamit dhe të parimeve islame, por kjo tregon se predikimet që janë transkriptuar nga librat, shtypi fetar dhe ligjëratat nga minberi, që mbahen përmendësh, janë si ligjëratat e kasetave, të cilat janë të lodhshme, të mërzitshme dhe joproduktive. Sipas klasifikimit të lartpërmendur të folësve, është e qartë se suksesi i të folurit është i lidhur ngushtë me pavarësinë dhe origjinalitetin e vetë folësit, kur është në pyetje interpretimi i disa njohurive. Përsëritja e qëndrimeve të autoriteteve, posaçërisht kur bëhet fjalë për mendime të vjetruara, të paargumentuara dhe të pabaza, ka mundësi që hatibin ta vënë në situatë shumë të vështirë.

Dëgjuesi/auditori gjithashtu, ka kërkesat e veta. Disa teoricienë të komunikimit, konsiderojnë se dëgjuesit e cilitdo qoftë ligjërues, parashtronjë pesë pyetje: – Kush je ti? – Çfarë do të flasësh? – Cilit mendon se do t'i flasësh? – Sa gjatë do të flasësh? – Çfarë kërkon nga unë? Dëgjuesi këto pyetje nuk i parashtron në mënyrë verbale/gojore, por ato i ka parasysh ndaj ligjëruesit. Duke përdorur këtë dhe rregulla të tjera komunikimi, hatibi/ligjëruesi mesazhin e këtij fjalimi do ta formësojë në bazë të strukturës së auditorit.

Duke pasur parasysh se hatibët ligjërojnë në kohën aktuale bashkëkohore, asnjë ligjërues nuk duhet t'i harrojë karakteristikat shpirtërore të auditorit, por edhe aftësitë e tyre të zhvilluara kritike. Në qoftë se kjo fuqi nuk ekziston ose nëse nuk është i zhvilluar shumë aspekti shpirtëror islam, atëherë ligjëruesi/hatibi është i detyruar që gradualisht ta zhvillojë atë të xhemati. Edhe pse në një kuptim, hutbeja është një monolog, derisa hatibi flet dhe dëgjuesit janë të detyruar që t'i dëgjojnë mesazhet e tij, kjo nuk do të thotë se ligjëruesi nuk ka mundësi që, pas mbarimit të hutbes, të ndajë kohë për të biseduar për temën e hutbes, bashkë me një grup më aktiv të dëgjuesve, për t'i dëgjuar reagimet e tyre në lidhje me ligjëratën. Një gjest i tillë do të ishte shumë i rëndësishëm. Në radhë të parë, me këtë ligjëruesit/hatibët e përcjellin shkallën e interesimit të dëgjuesve. Prandaj, me këtë veprim, hatibi i ka parasysh vërejtjet për sjelljen e tij të përgjithshme gjatë predikimit: dëgjuesi i vëmendshëm gjatë dëgjimit të hutbes do t'i fiksojë të gjitha fjalët karakteristike, gjestet, emocionet dhe të gjitha segmentet me të cilët shërben hatibi gjatë hutbes.

Dhe, në fund, hatibi fiton njohuri shumë të vlefshme në lidhje me temat e reja, të cilat do të mund të ishin interesante dhe të rëndësishme për dëgjuesit, të cilat ka arritur t'i kuptojë gjatë bisedës me dëgjuesit/xhematin e vet. Për të zhvilluar një formë të tillë të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të komunikimit, s'do mend që hatibi duhet t'i njohë personalisht dëgjuesit

e vet dhe me ata duhet të zhvillojë një bisedë të vazhdueshme. Të gjitha burimet për përgatitjen e temës, siç janë media, artikujt, faqet e internetit, hatibit mund t'i shërbejnë shumë. Por vetëm riprodhimi, leximi i materialeve të tilla e topit ose e çmpreh komunikimin ndërmjet hatibit dhe dëgjuesve dhe atë e redukton në rolin e folësit/spikerit apo të lexuesit.

Përveç kësaj, gjatë ekspozimit të temave të hutbes, secili hatib domosdoshmërisht përdor ajete nga Kurani dhe hadithe të Pejgamberit (a.s.), si pjesë e pashmangshme e përmbajtjes së hutbes, por konteksti në të cilin vendoset përmbajtja e domosdoshme dhe në të njëjtën kohë interpretohet, patjetër duhet të jetë në përputhje me kohën dhe rrethanat e kohës.

Hatibi e di që, me fjalimin e vet, i drejtohet personaliteteve të formuara, njerëzve që dinë të mendojnë, por, në të njëjtën kohë, që kanë edhe emocione, rezonime dhe ndjenja të ndryshme. Hutbeja nuk është një mbledhje shkencore dhe do të ishte e dobishme në qoftë se, në rrethana të caktuara, hatibi do t'i zgjonte, do t'i ngacmonte ndjenjat e dëgjuesve. Ai ndonjëherë duhet të jetë i ndjeshëm, por edhe humorist, modest, por këtë aspak nuk duhet ta bëjë në mënyrë teatrale, duke bërëtitur apo duke qarë, si dhe në asnjë mënyrë nuk duhet me diskursin e tij ta cenojë seriozitetin e materies, për të cilin bisedon, pra, fenë. Ligjëruesit nëpër xhami duhet t'i ndërpresin shikimet vëngër drejt dëgjuesve të tyre, sikur të ishin fëmijë. Siç dihet, nga ana e profesorëve të retorikës dhe psikologëve, sa më i lartë dhe më i kumbueshëm të jetë zëri, aq më pak i besueshëm është mesazhi. Kurani u drejtohet “njerëzve që të mendojnë”, ndaj edhe dijetarët duhet të bëjnë të njëjtën gjë.

Hutbeja është komunikim i drejtpërdrejtë që i bashkon jo vetëm fjalët dhe mendimet e njerëzve, por edhe frymën dhe gjallërinë e tyre, prandaj edhe mund të konsiderohet si forma më me ndikim në besimin dhe etikën e njerëzve, në krahasim me mediat e shkruara dhe elektronike. Përpos kësaj, ligjëratat verbale kanë fuqi që të kaluarën ta “konservojnë” dhe ta transformojnë sipas nevojës. Duke i pasur parasysh mangësitë dhe përparësitë e diskursit të përdorur në komunikimin e hutbes, gjithsesi, çdo hatib duhet që, krahas diturive fetare, të ketë edhe njohuri elementare të komunikologjisë bashkëkohore.